



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 133

Datë 20 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MAS nr. 15, datë 22.7.2014	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 18.2.2009 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.....	6047
Udhëzim i MAS nr. 17, datë 1.8.2014	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë.....	6047
Udhëzim i MAS nr. 18, datë 1.8.2014	Për zhvillimin e provimeve të maturës shtetërore 2014, sesioni i dytë.....	6048
Udhëzim i MAS nr. 19, datë 1.8.2014	Për procedurat e procesit të konkurrimit për tekste të botuesve të huaj për gjuhën frënge, përzgjedhjen dhe shitjen e tyre për vitin shkollor 2014-2015.....	6049
Udhëzim i MAS nr. 20, datë 6.8.2014	Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014-2015.....	6050
Udhëzim i MAS nr. 21, datë 8.8.2014	Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë..	6052
Udhëzim i MAS nr. 22, datë 8.8.2014	Për strukturën e vitit akademik 2014-2015 në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.....	6053
Udhëzim i MAS nr. 23, datë 8.8.2014	Për vitin shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar...	6053

Udhëzim i MAS nr. 24, datë 11.8.2014	Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014-2015.....	6063
Udhëzim i MAS nr. 25, datë 11.8.2014	Për procedurat që do të ndiqen për organizimin e procesit të transferimit të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë të cilëve iu është hequr licenca	6074

UDHËZIM
Nr. 15, datë 22.7.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5,
DATË 18.2.2009 TË MINISTRIT TË ARSIMIT
DHE SHKENCËS “PËR PËRMBAJTJEN DHE
FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 5, datë 18.2.2009, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 2 të shtohet:

“ç) “Doktoratë” në ... (fusha e studimit të kryer)”;

2. Germa “m” e pikës 4, të ndryshojë si më poshtë:

“m. Formën e studimeve, për ciklin e parë e të dytë të studimeve, si dhe, kur është përcaktuar në aktin e hapjes, për programin e doktoratës”;

3. Pas pikës 4.2 të shtohet pika 4.3, si më poshtë:

“4.3 Diploma për gradën shkencore “Doktor” për secilin doktorant, të përmbajë edhe numrin e diplomës së studimeve universitare, të përfunduar më parë, përkatësisht të studimeve të integruara të nivelit të dytë (DIND), “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”;

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Arsimore dhe Planifikimit Strategjik, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 17, datë 1.8.2014

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE
TË ARSIMIT BAZË 2014, SESIONI I DYTË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26, 27 dhe 50, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, si

dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektorit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:

a) Gjuha shqipe 27.8.2014;

b) Matematika 30.8.2014.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën “Gjuha amtare”, sesioni i dytë, në datën 25.8.2014.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në rregulloren nr. 2481, datë 9.4.2014, “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014”.

4. Provimet Kombëtare të Arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Hartimi i testeve të kryhet sipas rregullores nr. 2481, datë 9.4.2014, “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014”.

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, testi për provimin në lëndën “Gjuhë anëtare”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë tërheqin në DAR Gjirokastrë testin, ditën e provimit.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, testi për provimin në lëndën “Gjuhë amtare”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR-së Korçë.

8. Inspektorati Shtetëror i Arsimit të monitorojë procesin e Provimeve Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 18, datë 1.8.2014

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE 2014, SESIONI I DYTË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26, 27, 30 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

KREU I
PROVIME TË MATURËS SHTETËRORE 2014,
SESIONI I DYTË

1. Zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:

- a) Gjuhë e huaj 10 shtator 2014;
- b) Gjuha shqipe dhe letërsia 13 shtator 2014;
- c) Matematika 16 shtator 2014;
- d) Lëndë me zgjedhje 22 shtator 2014.

2. Provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në rregulloren nr. 895 prot., datë 7.2.2014, “Për procesin e Maturës Shtetërore 2014 në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00.

4. Testi për secilin nga provimet e detyruara të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe vlerësohen me 13 pikë, kurse 12 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 37 pikë.

5. Provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të lëndëve me detyrim të zgjasin 2 orë e 30 minuta secili.

6. Për provimin e detyruar të gjuhës së huaj testi të hartohet nga AKP-ja, ndërsa administrimi dhe vlerësimi të bëhet nga DAR/ZA-të. Për provimin D1, D2 dhe Z1, Z2, hartimi i testeve dhe vlerësimi i tyre të bëhet nga AKP-ja.

7. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje të jenë me përgjigje alternative dhe të vlerësohen me 10 pikë, kurse 10 pyetje të jenë me zgjidhje dhe të vlerësohen me 30 pikë.

8. Provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të lëndëve me zgjedhje të zgjasin 4 orë.

9. Maturantët që kanë vetëm një provim me zgjedhje, të hyjnë në provim në orën 11:30.

KREU II

**MATURANTËT/KANDIDATËT QË DO TË MARRIN
PJESË NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE
2014, SESIONI I DYTË**

1. Në provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, kanë të drejtë të marrin pjesë:

a) Maturantët/kandidatët që nuk rezultojnë kalues në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i parë;

b) Maturantët, që janë pakalues në një ose dy lëndë, në vitin shkollor 2013-2014 dhe i shlyejnë ato në sesionin e vjeshtës, në datat 2 dhe 5 shtator 2014;

c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2014, por nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore.

d) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit dhe kanë njehsuar dokumentet shkollore në komisionin e posaçëm të ngritur me urdhrin nr. 108, datë 31.3.2014 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, për “Ngritjen e komisionit të posaçëm për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit”, por që duhet të japin një apo dy provime me zgjedhje.

2. Për maturantët e përcaktuar në pikën 1, gerrat “a” dhe “b” është i vlefshëm formulari A1.

3. Kandidatët e përcaktuar në pikën 1, gerrat “c” dhe “d” që do të japin provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që i cakton DAR/ZA e vendbanimit. Për këtë kategori, plotësimi i formularit A1Z do të bëhet nga datat 1 deri 5 shtator 2014.

4. Drejtori i shkollës të dërgojë zyrtarisht në DAR/ZA listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, në datën 8 shtator 2014. Drejtori i DAR/ZA-së ta dërgojë këtë listë në AKP në datën 9 shtator 2014.

KREU III

ADMINISTRIMI I PROVIMEVE

1. Provimet të zhvillohen të përqendruara në drejtoritë arsimore rajonale.

a) ZA Tropojë, ZA Lushnjë dhe ZA Sarandë i zhvillojnë provimet në qytetet e tyre.

b) ZA Delvinë i zhvillon provimet në qytetin e Sarandës.

2. Drejtoritë arsimore rajonale dhe drejtoritë e shkollave marrin masa për njoftimin e maturantëve /kandidatëve për datat, mjedisin dhe orën kur do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i dytë.

3. Drejtori i DAR-së, brenda datës 8 shtator 2014, të njoftojë zyrtarisht AKP-në për mjediset ku do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë.

4. Në DAR ku rezulton se numri i maturantëve/kandidatëve është më i madh se 500, të përdoren 2 mjedise.

5. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të bazohet në rregulloren nr. 895 prot., datë 7.2.2014 “Për procesin e Maturës Shtetërore 2014 në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU IV

HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2014, SESIONI I DYTË

1. Hartimi i testeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të kryhet sipas rregullore nr. 895 prot., datë 7.2.2014 “Për procesin e Maturës Shtetërore 2014 në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Pas zhvillimit të çdo provimi të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen në AKP, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren nr. 895 prot., datë 7.2.2014 “Për procesin e Maturës Shtetërore 2014 në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të ndjekë procedurat e përcaktuara në rregulloren nr. 895 prot., datë 7.2.2014, “Për procesin e Maturës Shtetërore 2014 në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MAS-it dhe institucionet e varësisë, të cilët raportojnë në DAPU për çdo parregullsi të vërejtur.

5. Të gjitha shpenzimet e përfaqësuesve të MAS-it, gjatë provimeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, ku kanë qendrën e punës, sipas dispozitave në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar dhe të gjitha institucionet e varësisë së MAS-it.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 19, datë 1.8.2014

PËR PROCEDURAT E PROCESIT TË KONKURRIMIT PËR TEKSTE TË BOTUESVE TË HUAJ PËR GJUHËN FRËNGE, PËRZGJEDHJEN DHE SHITJEN E TYRE PËR VITIN SHKOLLOR 2014-2015

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shpalljen e konkurrit për pranim alternativash të teksteve të gjuhës frënge për klasat 11 dhe 12, në përputhje me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje të gjimnazit, në sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, për shkak të mungesës së teksteve dhe për të mundësuar pajisjen e nxënësve me tekste të botuesve të huaj.

2. Kërkesa, datat dhe detaje të tjera të procesit të konkurrit të publikohen në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit sipas aneksit “Për shpalljen e kërkesës për tekste të botuesve të huaj për gjuhën frënge”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit të ngrejë komisionin me specialistë të fushës për të bërë vlerësimin e përshtatshmërisë së teksteve me kurrikulën përkatëse. Komisioni të përbëhet nga së paku dy mësues me përvojë të gjuhës frënge, si dhe një pedagog i gjuhës frënge i Universitetit të Tiranës.

4. Përzgjedhja e teksteve të miratuara sipas këtij udhëzimi të bëhet nga mësuesit në shkollë sipas modaliteteve të udhëzimit të kësaj ministrie nr. 8, datë 24.3.2014 “Për përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2014-2015”, të ndryshuar, por pa cenuar përzgjedhjen e realizuar sipas tij.

5. Çmimet e shitjes me pakicë të këtyre teksteve në Shqipëri, të ofruara nga botuesit ose distributorët e autorizuar, të pranohen jo më lart se mesatarja e çmimeve aktuale të teksteve të gjuhëve të huaja për klasën dhe kurrikulën përkatëse, të përlllogaritura nga MAS.

6. Në procesin e shpërndarjes dhe shitjes, tekstet e miratuar sipas këtij udhëzimi të jenë të pajisura me pullën me hologramë të certifikimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Shitja e teksteve të bëhet nëpërmjet njërive tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave nga subjekte të licencuara deri në 15 shtator 2014.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

ANEKS

**PËR SHPALLJEN E KËRKESËS PËR TEKSTE TË
BOTUESVE TË HUAJ PËR GJUHËN FRËNGE**

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall publikisht kërkesën për tekste të botuesve të huaj për gjuhën frënge për klasat 11 dhe 12.

Tekstet e kërkuara duhet të kenë detyrueshmëri përputhje me programin përkatës në fuqi të gjuhës frënge, me kurrikulën bërthamë dhe me zgjedhje të detyruar të gjimnazit, për klasën e 11-të dhe të 12-të. Libri i nxënësit duhet të jetë i shoqëruar detyrueshmëri me fletoren përkatëse të punës, njësi e ndarë fizikisht nga libri i nxënësit ose e përfshirë si pjesë e dallueshme në librin e nxënësit.

Kërkesat do të pranohen vetëm nëpërmjet distributorëve të autorizuar prej botuesve. Distributori duhet të jetë i njohur ligjërisht për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të miratuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në datën 11 gusht 2014, nga ora 12.00 deri 16.00 në adresën Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Sektori i Kurrikulës, Cilësisë dhe Koordinimit, Rruga e Durrësit nr. 23, Tiranë (personi i kontaktit z. Piro Milo), distributori duhet të paraqesë këto dokumente:

a) 3 (tri) kopje të librit të nxënësit për të cilin kërkohet miratimi (fletorja e punës, njësi e ndarë fizikisht nga libri i nxënësit ose e përfshirë si pjesë e dallueshme në librin e nxënësit).

b) Ekstraktin historik të QKR-së për regjistrimin si person juridik me të drejtë ushtrimi aktiviteti si distributor, si dhe NIPT-in e subjektit.

c) Vërtetim nga gjykata që distributori nuk është në proces gjyqësor.

d) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse (jo më të vjetra se 3 muaj nga data e lëshimit).

e) Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit që subjekti nuk ka detyrime financiare karshi të tretëve dhe që distributori që përfaqëson nuk është në proces falimentimi (jo më të vjetra se 3 muaj nga data e lëshimit).

f) Delegimin zyrtar të së drejtës për përfaqësim distributorit, lëshuar nga shtëpia botuese e huaj, e regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin është themeluar botuesi, duke vërtetuar personalitetin ligjor të botuesit.

g) Deklaratat për çmimin e shitjes së tekstit të nxënësit dhe të fletores së punës, të shënuara me shifra dhe me shkrim, të paraqitura të ndara, në zarfe të mbylura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer në shqip dhe të noterizuara. Dokumentet, në asnjë rast, nuk i kthehen dorëzuesit.

UDHËZIM
Nr. 20, datë 6.8.2014

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË
PRANIMIT DHE TARIFËN E REGJISTRIMIT
PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME
STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË
PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2014-2015**

Mbështetur në nenin 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 33 dhe 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimi nr. 517, datë 1.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si edhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2014-2015”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006, “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Pranimet në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2014-2015, në:

1.1 Universitetin e Arteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë);

1.2 Universitetin e Sporteve të Tiranës (të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë);

1.3 Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë “Edukim Fizik dhe Sporte”);

1.4 Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (programi i studimit të ciklit të parë me kohë të plotë “Edukim fizik dhe sporte”);

1.5 Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë,

të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën - FASTIP);

a) Menaxhim i bankave (program në gjuhën angleze);

b) Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (program në gjuhën angleze) të bëhen mbi bazën e rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga këto institucione publike të arsimit të lartë.

2. Në Universitetin e Arteve të Tiranës rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, në programin ku ka konkurruar, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas përcaktimit për program studimi, nuk fiton të drejtën e studimit.

3. Në Universitetin e Sporteve të Tiranës rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, në programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte”, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe gjithë provimet e Maturës Shtetërore) të llogariten në masën 50%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit në masën 50%, sipas tabelës nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Në programet e studimit të FASTIP të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e viteve të shkollimit dhe e të gjithë provimeve të Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 40%, kurse rezultate e konkursit të pranimit (Gjuha Angleze dhe intervista e punësimit) në masën 60%, sipas tabelës nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, në programin ku ka konkurruar, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas përcaktimit për program studimi, nuk fiton të drejtën e studimit.

6. Për të gjitha programet e studimit, sipas pikës 1, të këtij udhëzimi, pikët minimale dhe maksimale të konkurseve përcaktohen në tabelën nr. 2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

7. Rregulloret dhe programet e konkurseve të miratuara nga IAL-të përkatëse, të bëhen publike, duke filluar nga data 5 gusht 2014.

8. Kandidatët që kanë përzgjedhur gjatë aplikimit me formularin A2, programet e studimit sipas pikës 1 të

këtij udhëzimi, kandidatët që përfitojnë nga kuotat e akorduar për shqiptarët jashtë kufijve të vendit, të verbrit, romët dhe ballkano-egjiptianët, invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë, jetimët, shtetasit e huaj, si dhe kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo transferim studimesh, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi, të regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës. Periudha e regjistrimit të jetë nga data 21 gusht deri në orën 12:00 të datës 28 gusht 2014.

9. Agjencia Kombëtare e Provimeve AKP, deri në datën 19 gusht 2014, të përgatisë listën e konkurrentëve për konkurset e pranimit në programet e studimit sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, sipas preferencave të kërkuara prej tyre në formularin A2.

10. Lista e konkurrentëve për secilin konkurs pranimit të pikës 1 për të gjithë kandidatët që kanë plotësuar formularin 2, t'u dorëzohen nga AKP-ja institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve të studimit, në formë të shkruar dhe elektronike, brenda orës 12:00 të datës 20 gusht 2014. Së bashku me listat e konkurrentëve dërgohen pranë IAL-ve publike dhe udhëzimet teknike për hedhjen e pikëve të konkurseve në sistemin e maturës shtetërore *online*, si dhe username dhe passwordet e skretarive të fakulteteve.

Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e akorduara për shqiptarët jashtë kufijve të vendit, të verbrit, romët dhe ballkano-egjiptianët, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, jetimët shtetasit e huaj si dhe kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi apo transferim studimesh, që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi, aplikojnë drejtpërdrejt në institucionet përkatëse të arsimit të lartë publik.

11. Rektoratet dhe dekanatet e IAL-ve publike të shpallin në mjedise të dukshme të institucioneve të tyre deri në datën 8 gusht 2014 datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për të siguruar një ecure normale të procesit të regjistrimeve në konkursin e pranimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë.

12. Sekretaritë mësimore të fakulteteve përkatëse, të programeve të studimit të pikës 1, pas verifikimit të listave të të regjistruarve, me listën e dorëzuar nga AKP, në datën 29 gusht 2014, ora 12:00, të shpallin listat e konkurrentëve të regjistruar dhe t'i afishojnë ato në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve të tyre.

13. Datat e konkursit të pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë, të jenë sipas këtij kalendari:

13.1 Universiteti i Arteve, Tiranë në periudhën 1 shtator - 5 shtator 2014

13.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës në periudhën 1 shtator - 4 shtator 2014

13.3 Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër për programin e studimit:

a) Edukim fizik dhe sporte 2 shtator - 5 shtator 2014

13.4 Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan për programin e studimit

a) Edukim fizik dhe sporte 2 shtator-5 shtator 2014

13.5 Universiteti “A. Moisiu” Durrës, për të gjitha programet e studimit të përcaktuara në pikën 1.5 të këtij udhëzimi: 1 shtator - 3 shtator 2014.

14. Tarifat e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë, të jenë si më poshtë:

i) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Sporteve të Tiranës 5000 (pesë mijë) lekë;

ii) Në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, Tiranë 5000 (pesë mijë) lekë;

iii) Në programet e studimit në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër “Edukim fizik dhe sporte” 5000 (pesë mijë) lekë;

iv) Në programin e studimit “Edukim Fizik dhe Sporte” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan 5000 (pesë mijë) lekë.

15. Të gjitha tarifat e regjistrimit për konkurrim në programet e ndryshme të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë të arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrate të postës shqiptare, për llogari të IAL-së publike përkatëse.

16. Konkurset e pranimit në këto institucione publike të arsimit të lartë të monitorohen nga përfaqësues të MAS.

17. Rezultatet e konkurseve të pranimit hidhen në portalin e Maturës Shtetërore *online* nga sekretaritet e fakulteteve sipas procedurave të udhëzimit teknik të dërguar nga AKP-ja. Më pas ato dërgohen në MAS e në AKP. Në formë shkresore dhe elektronike (në CD), brenda 3 ditëve nga përfundimi i tyre.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike përkatëse të Arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 21, datë 8.8.2014

**PËR RRIJTJEN E NDJEKJES SË ARSIMIT
PARASHKOLLOR NGA FËMIJËT ROMË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Në zbatim të nismës “Çdo fëmijë rom në kopsht”, kopshtet dhe shkollat që kanë në varësi kopshte, të marrin masa për ndjekjen e kopshtit nga fëmijët romë. Për këtë:

1. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore:

a) Të hartojnë një plan veprimi për rritjen e ndjekjes së kopshtit dhe integrimin e fëmijëve romë në kopshte për vitin shkollor 2014-2015. Plani i veprimit të përmbajë: objektiva të matshëm, statistikave të komunitetit rom, të dhënat për fëmijët romë 3-6 vjeç, si dhe tregues progresi, që do të jenë të njëjtë për të gjitha DAR-ZA-të dhe do t’u dërgohen nga MAS-i.

b) Të raportojnë në Drejtoritë e Arsimit Parauniversitar në MAS treguesit e progresit (në fund të muajve tetor, janar dhe qershor).

c) Të bashkëpunojnë me njësitë baze të qeverisjes vendore për rastet kur prindi nuk e ka certifikatën e lindjes së fëmijës apo vërtetimin e vaksinimeve të tij.

d) Të monitorojnë rastet e kopshteve dhe shkollave që nuk kanë të regjistruar fëmijë romë në kopsht, edhe pse këta fëmijë banojnë në zonat në juridiksion të atyre kopshteve e shkollave.

e) Të monitorojnë punën e kopshteve e shkollave që kanë në varësi kopshte për integrimin e fëmijëve romë.

f) Të sigurojnë përkujdesje të posaçme të psikologut/punonjësit social për fëmijët romë që ndjekin kopshtin.

g) Të shohin me përparësi sigurimin e transportit për fëmijët romë të moshës parashkollore.

2. Drejtuesit e kopshteve dhe drejtuesit e shkollave që kanë në varësi kopshte:

a) Të regjistrojnë me përparësi fëmijët romë në kopshte, sidomos në zonat e banuara nga popullsia romë. Në rastet kur kopshti nuk ka kapacitet për të përmbushur nevojat e bashkësisë përreth tij, t’u jepet përparësi fëmijëve të komunitetit rom.

b) Të bashkëpunojnë me njësitë bazë të qeverisjes vendore për të mundësuar që fëmijët romë të përjashtohen nga pagesa e depozitës së garancisë në Tiranë dhe nga pagesat e boreve të prindërve romë në të gjithë vendin.

c) Të krijojnë atmosferë mikpritëse në kopsht për fëmijët romë dhe për prindërit e tyre gjatë procesit të regjistrimit dhe gjatë gjithë kohës që fëmijët romë do të ndjekin kopshtin.

d) Të punojnë, duke aktivizuar edukatorët dhe stafin lehtësues të kopshteve për sensibilizimin dhe edukimin e prindërve të fëmijëve romë mbi rëndësinë e parashkollorit dhe çështje të tjera, si: shëndeti, ushqimi, higjiena etj.

II. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit,

drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, kopshtet dhe shkollat që kanë në varësi kopshte.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 22, datë 8.8.2014

PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2014-2015 NË INSTITUCIONET PUBLIKE DHE PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2014-2015 në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë, të fillojë në datën 20 tetor 2014 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2015.

2. Periudha 22 dhjetor 2014 deri më 4 janar 2015, të jetë periudhë pushimesh për studentët.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet “Trajtimi i studentëve” listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

1. ARSIMI BAZË

STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR

Klasa	Mësim	Pushime	Provime lirimi	Festa
I - IX	35 javë	I. 24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015 II. 26 deri 31 mars 2015	6 – 30 qershor 2015	7 ditë

PLANI MËSIMOR I KLASAVE 1-9

Nr.	Lëndët	Klasat								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)	8	8	6	5	5	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	-	-	2	2	2	2	2	3	3
3	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
4	Dituri natyre	-	-	2	3	2				
5	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, ndërmarrjet “Trajtimi i studentëve” sh.a. dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 23, datë 8.8.2014

PËR VITIN SHKOLLOR 2014-2015 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe germës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I
STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR DHE
PLANET MËSIMORE

6	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
7	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
8	Vendlindje	-	-	-	-	2	-	-	-	-
9	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
10	Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
11	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
12	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
13	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	2	2	2
14	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
15	Edukim fizik	3	3	3	3	3	3	3	3	3
16	Informatikë							1	1	1
17	Veprimtari jashtëkurrikulare dhe lëndë me zgjedhje	-	-	-	1	1	1	-	-	-
	Gjithsej orë/javë:	20	20	22	23	23	27	29	29	29

PLANI MËSIMOR I SHKOLLAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE, KLASAT 1-9

Nr	LËNDA	K L A S A T								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	8/7	6	5	4	4	4	4	4	3
02	Gjuhë shqipe dhe lexim letrar	0/2	5	5	5	5	4	4	4	4
3	Gjuhë e huaj	-	-	-	-	-	2	2	2	2
4	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
5	Dituri natyre	-	-	2	3	2	-	-	-	-
6	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
7	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
8	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
9	Vendlindja					2				
10	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
11	Gjeografi	-	-	-		-	2	2	2	2
12	Histori amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	-	1
13	Gjeografi amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	1	-
14	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
15	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
16	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	1	1	2
17	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
18	Edukim fizik	3	3	3	3	3	3	3	3	3
19	Informatikë							1	1	1
	Gjithsej orë/javë:	20/21	23	24	24	24	29	31	31	31

PLANI MËSIMOR I SHKOLLËS SPECIALE "LUIGJ GURAKUQI"

Nr.	Lëndët	Klasat								
		1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Gjuhë amtare: Abetare, komunikim, elemente shkrimi, ushtrim të foluri	10	10	10	10	10	4	4	4	4
2	Matematikë dhe zhvillim logjik	5	5	5	5	5	3	3	3	3
3	Punë dore dhe art	3	3	3	3	3	2	2	2	2
4	Edukim shoqëror	2	2	2	2	2	2	2	2	2

5	Edukim shëndetësor dhe vetëshërbim	2	2	2	2	2	2	2	2	2
6	Edukim fizik	3	3	3	3	3	3	3	3	3
7	Edukim muzikor dhe muzikoterapi	2	2	2	2	2	2	2	2	2
8	Terapi të foluri me seanca individuale	2	2	2	2	2	2	2	2	2
9	Orientim dhe njohje me mjedisin	1	1	1	1	1	1	1	1	1
10	Mësim pune	-	-	-	-	-	9	9	9	9
Gjithsej orë/javë:		30	30	30	30	30	30	30	30	30

2. ARSIMI I MESËM I LARTË

a) GJIMNAZI ME KOHË TË PLOTË

STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR

Klasa	Mësim	Pushime	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XI	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	23 maj – 30 qershor 2015	7 ditë
XII-XIII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015		

PLANI MËSIMOR I KLASAVE 10-12, ARSIMI I MESËM I LARTË

Nr.	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Arte (muzika, vallëzimi, teatri, arti pamor) Histori arti	1	1	1
2	Edukim fizik dhe sporte	3	3	3
3	Gjuhë e huaj e parë	3	3	4
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3	3	4
5	Karriera, aftësimi për jetën	1	1	1
6	Matematikë	3	3	4
7	Kimi	2	2	-
	Fizikë	2	2	-
	Biologji	2	2	-
	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	2	-	-
	Shkenca natyrore			2
8	Qytetari	2	1	-
	Histori	1	2	2
9	Gjeografi	-	1	2
	Ekonomi	-	-	2
	TIK	2	1	-
	Teknologji	-	-	2
	Shuma:	27	25	27
	Zgjedhja e detyruar	2-4	4-6	2-4
	Zgjedhja e lirë	1	1	1
Gjithsej orë/javë:		31-32	31-32	31-32

b) GJIMNAZI ME KOHË TË PJESSHME

STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR

Klasa	Mësim	Pushime	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XII	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	23 maj – 30 qershor 2015	7 ditë
XIII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015		

PLANI MËSIMOR I GJIMNAZIT ME KOHË TË PJESSHME

Nr.	Lëndët	Klasa X (orë/kredite)	Klasa XI (orë/kredite)	Klasa XII (orë/kredite)	Klasa XIII (orë/kredite)	Orë gjithsej	Kredite gjithsej
1	Gjuhë e huaj e parë	72/2	72/2	108/3	102/3	354	10
2	Gjuhë shqipe dhe letërsi	72/2	108/3	72/2	102/3	354	10
3	Matematikë	108/3	72/2	72/2	102/3	354	10
4	Kimi	72/2	36/1	36/1		144	4
5	Fizikë	72/2	36/1	36/1		144	4
6	Biologji	72/2	36/1	36/1		144	4
7	Shkenca e tokës	72/2				72	2
8	Qytetari		72/2	36/1		108	3
9	Histori		36/1	72/2	68/2	176	5
10	Gjeografi		36/1	36/1	34/1	106	3
11	Ekonomi				68/2	68	2
12	TIK		36/1	36/1	34/1	106	3
	Gjithsej:	540/15	540/15	540/15	510/15	2130	60

- Gjimnazet me kohë të pjesshme të punojnë me programet dhe tekstet mësimore të gjimnazit me kohë të plotë.
- Klasat X-XIII në gjimnazin me kohë të pjesshme të organizojnë regjistrimet dhe të realizojnë procesin mësimor sipas Udhëzimit Nr. 35, datë 31.08.2011 "Për strukturën, planin mësimor dhe veprimtarinë mësimore të shkollave me kohë të pjesshme" dhe Udhëzimit nr. 23, datë 02.08.2013 "Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme".
- Nxënësit e klasës XIII të sistemit të korrespondencës, që në vitin 2013-2014 kanë mbetur ose nuk janë paraqitur në më shumë se dy lëndë, t'i japin provimet në vitin shkollor 2014-2015, sipas kalendarit të mposhtëm:

Datat	Lëndët që do të jepen provim
13 dhjetor 2014	Gjuhë Shqipe dhe letërsi Gjeografi TIK
17 janar 2015	Matematikë Gjuhë e huaj Histori
21 shkurt 2015	Ekonomi Edukim për karrierën

3. ARSIMI I ORIENTUAR**Shkollat e mesme artistike 3-vjeçare dhe koreografike**

Klasa	Mësim	Pushime	Praktikë e grupuar	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XI	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	-	7 ditë
XII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	23 maj – 30 qershor 2015	

Shkollat e mesme artistike 4-vjeçare

Klasa	Mësim	Pushime	Praktikë e grupuar	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	-	7 ditë
XIII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	23 maj – 30 qershor 2015	

Shkollat e mesme sportive

Klasa	Mësim	Praktikë e grupuar	Takime sportive	Pushime	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X	34 javë	2 javë	3	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	7 ditë
XI - XII	32 javë	4 javë	4	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	
XIII	32 javë	4 javë	4	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	23 maj-30 qershor 2015	

4. ARSIMI PROFESIONAL**Struktura 2+1+1**

Klasa	Mësim	Pushime	Provime përfundimtare të Nivelit	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	-	7 ditë
XI - XII	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	-	
XIII	32 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	23 maj – 30 qershor 2015	

Struktura 2+2

Klasa	Mësim	Pushime	Provime përfundimtare të Nivelit	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	-	7 ditë
XI	34 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	-	
XII	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	-	
XIII	32 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	23 maj – 30 qershor 2015	

Struktura 4 vjet bllok

Klasa	Mësim	Pushime	Provime përfundimtare të Nivelit	Provime të Maturës Shtetërore	Festa
X - XII	36 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	-	-	7 ditë
XIII	32 javë	24 dhjetor 2014 – 4 janar 2015	2 javë	23 maj – 30 qershor 2015	

Sesioni i provimeve të Teorisë dhe Praktikës Profesionale të Integruar për shkollat profesionale të jetë:

Niveli I dhe Niveli II: 25 maj – 5 qershor 2015. Niveli III: 11 - 22 maj 2015.

Provimet e formimit teorik dhe praktik në shkollat artistike e sportive dhe në gjimnazet gjuhësore të zhvillohen në periudhën 11 deri 22 maj 2015. Këto provime të vlerësohen me notë. Kjo notë të mos përfshihet në mesataren e përgjithshme.

Struktura e arsimit profesional me kohë të pjesshme të jetë e njëjtë me atë të arsimit profesional me kohë të plotë.

KREU II
BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONEVE ARSIMORE

1. Veprimtaria e institucioneve të arsimit parauniversitar të realizohet në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-ve dhe të urdhrave e udhëzimeve në fuqi, të nxjerra nga Ministri, si më poshtë:

- Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar, 2013.

- Kodi i Etikës së Mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga mistri i Arsimit dhe Sportit me 30 nëntor 2013.

- Urdhri nr. 307, datë 14.7.2014, “Për strukturën e vitit shkollor 2014-2015 në sistemin arsimor parauniversitar”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”.

- Urdhri i Kryeministrit nr. 41, datë 2.4.2013 dhe vendimit të ministrisë të BUMK nr. 7, datë 4.6.2013, “Për ngritjen e grupit ndërministror për të punës për koordinimin dhe kontrollin e fushatës së vaksinimit oral kundër sëmundjes së tërbimit”.

- Urdhri i Kryeministrit nr. 232, datë 2.12.2013, “Për ngritjen e grupit nderinstitucional të punës për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave në RSH”.

- Urdhrit nr. 66, datë 18.3.2014, “Për ngritjen e grupit teknik për zyrtarizimin e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”.

- Urdhri nr. 323, datë 7.8.2014, “Për pilotimin e kurrikulës së re në institucionet arsimore të arsimit bazë në sistemin arsimor parauniversitar”.

- Urdhri nr. 169, datë 8.5.2014, “Për disa ndryshime në Dispozitat Normative në sistemin arsimor parauniversitar” (vlerësimi i nxënësve në arsimin profesional).

- Urdhri nr. 26, datë 21.1.2014, “Për mënyrën e administrimit dhe funksionimit të shkollave profesionale gjatë periudhës së transferimit të përgjegjësisë nga MAS në MMSR”.

- Urdhri nr. 344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e njësive të shërbimit psikosocial”.

- Udhëzimi nr. 17, datë 1.8.2014, “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë”.

- Udhëzimi nr. 18, datë 1.8.2014, “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2014, sesioni i dytë”.

- Udhëzimi nr. 2, datë 5.2.2014, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.

- Udhëzimi nr. 5, datë 25.2.2013, “Për standardet e përgjithshme të mësuesit”.

- Udhëzimi nr. 8, datë 24.3.2014, “Për zgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2014 -2015”, i ndryshuar.

- Udhëzimi i përbashkët me Ministrinë e Financave nr. 15, datë 28.5.2010, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar dhe universitar”.

- Udhëzimi nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klase në institucionet e arsimit parauniversitar”.

- Udhëzimi nr. 33, datë 1.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licence të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”.

- Udhëzimi nr. 21, datë 2.5.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e medaljes së artë”.

- Udhëzimi nr. 23, datë 2.5.2013, “Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme”.

- Udhëzimi nr. 24, datë 2.5.2013, “Për certifikimin e hartuesve të teksteve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare”.

- Udhëzimi nr. 25, datë 2.5.2013, “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”.

- Udhëzimi nr. 26, datë 2.5.2013, “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve”.

- Udhëzimi nr. 27, datë 2.5.2013, “Për bordin e institucionit arsimor”.

- Udhëzimi nr. 28, datë 2.5.2013, “Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase”.

- Udhëzimi nr. 29, datë 2.5.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”.

- Udhëzimi nr. 30, datë 2.5.2013, “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”.

- Udhëzimi nr. 31, datë 2.5.2013, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klase të arsimit bazë”.

- Udhëzimi nr. 34, datë 2.5.2013, “Për planifikimin e fondeve buxhetore dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave të institucioneve arsimore publike”.

- Udhëzimi nr. 36, datë 13.8.2013, “Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar”.

- Udhëzimi nr. 38, datë 13.8.2013, “Për arsimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore”.

- Udhëzimi nr. 43, 21.8.2013, “Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike”.

- Udhëzimi nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.

- Udhëzimi nr. 56, datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin arsimor publik”.

- Udhëzimi nr. 57, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik".

- Udhëzimi nr. 58, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik".

- Rregullorja nr. 336, datë 14.7.2011, "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit".

2. Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të ndjekin me përparësi realizimin e çdo veprimtarie në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, për këtë:

a) Drejtoria e Shërbimeve Juridike të dërgojë në çdo DAR/ZA të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe çdo akt i tillë që do të dale gjatë vitit shkollor.

b) Drejtoria e Arsimit Parauniversitar të monitorojë realizimin e detyrave që rrjedhin nga baza ligjore mbi të cilën mbështesin veprimtarinë e tyre institucionet arsimore parauniversitare.

c) DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore të bashkëpunojnë me OJF-të e donatorë dhe të ndihmojnë shkollat për zbatimin e udhëzimeve, nismave, të projekteve e marrëveshjeve të ndryshme vetëm me miratim nga MAS-i.

KREU III

VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

I. ARSIMI PARASHKOLLOR

1. Kurrikula e arsimit parashkollor të bazohet në këto dokumente:

- Standardet e përmbajtjes;
- Standardet e arritjeve;
- Programet e arsimit parashkollor për çdo grup.

2. DAR/ZA-të, drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve publik të ndjekin me përparësi:

- Regjistrimin në klasën përgatitore të fëmijëve 5-vjeçare që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin;
- Regjistrimin në kopsht të fëmijëve nga familjet në nevojë, rome, egjiptiane dhe fëmijët me aftësi të kufizuara;

c) Vijimin pa ndërprerje të aktivitetit të kopshteve me ose pa ushqim gjatë gjithë vitit kalendarik.

3. Mësuesit e kopshteve të hartojnë dhe të zbatojnë programe individuale edukative për fëmijët me nevoja të veçanta, në bashkëpunim me prindërit e këtyre fëmijëve.

4. Në çdo kopsht të ngrihen, sipas legjislacionit në fuqi, bordi, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve dhe komisioni i etikës e sjelljes.

II. ARSIMI BAZË

Procesi mësimor në arsimin bazë të zhvillohet sipas planeve dhe programeve mësimore në fuqi dhe kurrikulës së miratuar.

1. DAR/ZA-të të ndjekin me përparësi:

a) Ngritjen dhe funksionimin në shkollat e zakonshme të komisioneve për fëmijët me aftësi të kufizuara (ku ka fëmijë të tillë);

b) Pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të tyre në njësitë e ngritura pranë bashkive/komunave për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi;

c) Plotësimin e nevojave dhe kërkesave për arsimim në gjuhën amtare të pakicave kombëtare.

2. Shkollat e arsimit bazë të ndjekin me përparësi:

a) Bashkëpunimin me bordin, me këshillin e prindërve të shkollës, me këshillin e prindërve të klasës, me qeverinë e nxënësve, me njësinë vendore për mbrojtjen e fëmijës dhe me organizata jofitimprurëse.

b) Organizimin e mësuesve për të siguruar regjistrimin e nxënësve që i përkasin zonës së shkollës, si dhe ruajtjen e një numri të balancuar të nxënësve për klase mes shkollave të një zone.

c) Regjistrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe nga shtresat në nevojë.

3. Mësuesit e shkollave 9-vjeçare të zakonshme të hartojnë dhe të zbatojnë programe individuale edukative për fëmijët me nevoja të veçanta në bashkëpunim me prindërit e këtyre fëmijëve.

4. Drejtoritë e shkollave dhe mësuesit të organizojnë përkujdesje të posaçme për nxënësit me vështirësi në të nxënë, sipas neneve të DN.

5. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave të ndjekin:

a) Mësimin e gjuhës së huaj (angleze, frënge dhe italiane), duke filluar nga klasa e tretë e arsimit fillor, sipas parapëlqimeve të nxënësve dhe mundësive të shkollës, në respektim të parimit të shumëgjuhësisë;

b) Zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për programin "Iliria", duke synuar që 10% e numrit të nxënësve të mësojnë gjuhën italiane;

c) Zbatimin e angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Botërore të Frankofonisë, duke synuar që 30% e nxënësve që mësojnë gjuhë të huaj, të mësojnë gjuhën frënge;

d) Sigurimin e vijimësisë së studimit të gjuhës së huaj të parë dhe të dytë (në shkollat të cilat e aplikojnë) nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë.

Brenda datës 30 shtator 2014, DAR/ZA-të të raportojnë në DAPU (MAS) realizimin e detyrave të pikës 5.

III. ARSIMI I MESËM I LARTË

1. DAR/ZA-të dhe drejtoritë e gjimnazeve, krahas zbatimit cilësor të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje të detyruar, t'i kushtojnë vëmendje të posaçme hartimit dhe të zbatimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë, në përgjithësi, dhe të shërbimit komunitar, në veçanti. Në ndihmë të zbatimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë, drejtoritë e gjimnazeve të përfshijnë në kurrikulën me zgjedhje të lirë, sipas kushteve të shkollës, modulet

profesionale të hartuara nga IZHA-ja dhe që gjenden në: www.izha.edu.al. Moduli “Ju dhe biznesi”, hartuar nga Dhoma e Tregtisë Durrës, të përfshihet në listën e moduleve me zgjedhje të lirë të gjimnazit.

2. Në vijim të zbatimit të marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, edhe gjatë vitit shkollor 2014-2015, klasat XI dhe XII të shkollave të përzgjedhura të zhvillojnë programin “Arritje Rinore” (*Junior Achievement*) në kurrikulën me zgjedhje të lirë. DAR/ZA-të t’u mundësojnë zbatimin e këtij projekti të gjitha shkollave të përzgjedhura dhe të marrin masa për krijimin e dy klasave (një klasë e 11-të dhe një klasë e 12-të) që do të zgjedhin modulet e programit “Arritje Rinore”.

3. Gjimnazet me orientim gjuhësor të punojnë me planin mësimor nr. 1023, datë 17.2.2011. për vlerësimin e projekteve shkollore të zbatohen udhëzimet e dhëna në shkresën e MAS-it nr. 560/1 prot., datë 10.2.2014. Në mbështetje të planit mësimor, nxënësit të plotësojnë 90-94 kreditë. Kreditet e kurrikulës me zgjedhje të lirë të planifikohen nga shkolla për nxënësit që dëshirojnë t’i zhvillojnë.

4. Funksionimi i seksioneve dygjuhëshe shkollore të mbështetet në zbatimin e memorandumeve dhe marrëveshjeve përkatëse të dërguara në DAR/ZA. Plani mësimor, programet dhe tekstet e zgjedhura që zbatohen në tri seksionet dygjuhëshe, janë bashkëlidhur me dokumentet e nënshkrimit. Drejtoritë e shkollave të sigurojnë bashkëpunim midis ekipeve lëndore të seksioneve dhe atyre të gjimnazeve ku funksionojnë seksionet. DAR-të dhe drejtoritë e gjimnazeve të marrin të gjitha masat për krijimin e mjediseve shkollore në ndihmë të mbarëvajtjes së punës në seksionet dygjuhëshe shkollore.

5. Në strukturën 2+1+1, të arsimit profesional, Niveli III të ofrohet vetëm me drejtime mësimore, pra nxënësit që kanë përfunduar Nivelin II (klasa XII) në një nga profilet mësimore të një drejtimi të caktuar, të vijojnë Nivelin III (klasa XIII) vetëm në drejtimin mësimor përkatës. P.sh., nxënësit e profileve “Shërbime motorike” dhe “Shërbime xhenerike”, klasa XII, të vijojnë shkollimin në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, klasa XIII. Kjo do të thotë që, nxënësit që përfunduan klasën XII në profile të ndryshme të të njëjtit drejtim, mund të bashkohen në klasa të përbashkëta dhe të ndjekin drejtimin mësimor përkatës në klasën XIII.

6. Në strukturën 2+2, të arsimit profesional, Niveli III të vazhdojë me profile mësimore. Nxënësit që kanë përfunduar Nivelin I (klasa XI) në një nga drejtimet mësimore, mund të vijojnë Nivelin III (klasa XII-XIII) vetëm në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Realizimi i programeve analitike për disa lende të

veçanta, i moduleve të praktikave profesionale në të gjitha nivelet (të grupuara, të shpërndara, në mjediset e praktikave të shkollës, në biznese etj.), i moduleve praktike me zgjedhje të detyruar, i moduleve me zgjedhje që përmban skelet-kurrikuli përkatës dhe i moduleve që mund të hartohen/propozohen si të rëndësishme për formimin e nxënësve, brenda numrit të orëve të parashikuara, të behet sipas procedurave dhe përvojës së viteve të kaluara. Llogaritja e krediteve dhe e pikëve për shkollat profesionale, artistike dhe sportive të behet si në gjimnazin me kohë të plotë (të gjitha lëndët kanë koeficientin 1).

IV. ARSIMI PARAUNIVERSITAR PRIVAT

1. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore:

a) Të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat dhe t’i ndihmojnë atë për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, si dhe veprimtarive jashtëshkollore dhe rajonale e kombëtare;

b) Të kërkojnë raportim për numrin e nxënësve të regjistruar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private:

a) Të raportojnë në DAR/ZA, në fillim të vitit shkollor, adresën, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në dispozitat normative 2013;

b) Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”.

V. REGJISTRIMI I NXËNËSVE DHE PAJISJA ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në institucionet arsimore parauniversitare të kryhen në përputhje me Dispozitat Normative dhe me udhëzimet në fuqi.

2. DAR/ZA-të, sipas afateve të përcaktuara në formularin operativ “Lëvizja dhe balancimi i kontingjenteve të nxënësve”, të dërgojnë në MAS të dhënat mbi lëvizjet e nxënësve të arsimit bazë.

3. Drejtoritë e shkollave të afishojnë, në një vend të dukshëm në shkollë, listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit për çdo klasë të shkollës, vendi ku do të blihen tekstet, si dhe periudha në të cilën do të shiten, sipas një grafiku për çdo klasë.

4. DAR/ZA-të, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi procesin e shpërndarjes dhe

shitjes së teksteve shkollore, në mënyrë” që më 15 shtator të mos mbetet asnjë nxënës pa u pajisur me të gjitha tekstat shkollore që do t'i duhen t'i përdorë gjatë vitit shkollore 2014-2015.

5. DAR/ZA-të të njoftojnë zyrtarisht MAS-in për ecurinë e procesit të pajisje së nxënësve me tekste shkollore.

VI. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE

DAR/ZA-të, nëpërmjet mjeteve profesionale, takimeve me personelin mësimor të shkollave e përhapjes së përvojave të suksesshme me anën e letrave qarkulluese, dhe drejtoritë e institucioneve arsimore, nëpërmjet këshillit të mësuesve ose ekipeve lëndore, të kenë përparësi tema, të tilla si:

1. Kompetencat themelore në hartimin dhe zbatimin e kurrikulës.

2. Etika e mësuesve me nxënësit.

3. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin e mësimdhënies e të të nxënës dhe në administrimin e shkollës.

4. Integriteti kurrikular në çdo fushë të nxënës dhe ndërmjet fushave të të nxënës.

5. Formimi i të menduarit kritik, i të menduarit krijues dhe i aftësive të të punuarit në grupe të vogla.

6. Rregullorja e brendshme e shkollës.

7. Hartimi i karakteristikës së nxënësit në dëftesën shkollore.

8. Udhëzuesi i Kartës së Performancës së shkollës.

9. Shkollat si qendra komunitare.

10. Hartimi i planit afatmesëm dhe i planit vjetor të shkollës.

VII. INSPEKTIMI

1. Inspektorati Shtetëror i Arsimit të ketë përparësi:

a) Dokumentacionin e shkollave që përmban përpunimin e të dhënave, pjesë e Kartës së Performancës;

b) Cilësinë e shërbimit arsimor që ofrojnë DAR/ZA-të;

c) Pilotimin e kurrikulës së re nëpërmjet hartimit të instrumenteve dhe treguesve të rinj;

d) Procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve vjetore në institucionet arsimore parauniversitare;

e) Monitorimin e procesit të përzgjedhjes dhe të shpërndarjes së teksteve shkollore;

f) Monitorimin e Provimeve të Lirimit dhe të Maturës Shtetërore, zhvillimin e olimpiadave etj.;

g) Procesin e vlerësimit në klasat I-III, në zbatim të nenit 15 të DN;

h) Shërbimin psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar në funksion të edukimit kundër dhunës (fizike, psikologjike) dhe sjelljeve të rrezikshme;

i) Zbatimin e legjislacionit për procedural e emërimit dhe shkarkimit të drejtuesve dhe mësuesve në institucionet arsimore publike të sistemit parauniversitar;

j) Cilësinë e shërbimit arsimor që ofrojnë shkollat e specializuara;

k) Funksionimin e gjimnazeve me kohë të pjesshme (publike dhe private);

l) Projektet lëndore dhe ndërlëndore;

m) Vlerësimin e edukimit artistik dhe sportiv në shkolla;

n) Ngritjen dhe funksionimin e organizmave në institucionet arsimore.

2. Inspektorati Shtetëror i Arsimit të informojë ministrin, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet arsimore për gjetjet e inspektimeve që do të kryejë.

VIII. FUNKSIONIMI I ORGANIZMAVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE

Në çdo institucion arsimor t'i jepet përparësi ngritjes dhe funksionimit, sipas legjislacionit në fuqi, të organizmave: bordi i institucionit arsimor, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve të institucionit arsimor, këshillat e prindërve të klasave, komisioni i disiplinës, komisioni i etikes dhe sjelljes, komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.

IX. KONKURSET

1. Në përfundim të konkurseve kombëtare vjetore për gjitha shkollat e vendit me temat: *Projektet kurrikulare, Risi të shkollave në përkujdesjen ndaj nxënësve në vështirësi për të nxënësve, Risi të shkollave si qendra komunitare, një komision qendror*, i ngritur me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të shpallë 10 shkollat/mësuesit fitues.

2. Çdo DAR/ZA, brenda muajit shtator 2014, të shpallë dy tema për konkurrim sipas përparësive vjetore që ka DAR/ZA-ja dhe shkollat në juridiksion.

3. Çdo kopsht/shkollë të shpallë konkursin vjetor për një ose dy tema të përzgjedhura nga këshilli i mësuesve. Dy mësuesit fitues të shpallen nga një komision i ngritur nga drejtori i institucionit arsimor.

DAR/ZA-të të organizojnë ceremoni të posaçme për shpalljen e rezultateve të konkurseve në fund të vitit shkollore ose në fillim të vitit shkollore pasues.

X. VEPRIMTARI SHKOLLORE DHE JASHTË-SHKOLLORE

1. Veprimtaritë shkollore dhe jashtëshkollore, si dhe veprimtari të tjera plotësuese, si: olimpiadat, kurset, kampionatet, festivalet etj., të organizohen e të realizohen pa cenuar orët mësimore të parashikuara në programet lëndore, për asnjë nxënës.

2. DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore të hartojnë planin e veprimtarive për 70-vjetorin e çlirimit, në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 116, datë 10.3.2014.

3. DAR/ZA-të dhe institucionet arsimore të ndjekin dhe të realizojnë veprimtaritë në kuadër të nismës “Shkollat si Qendra Komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”.

4. Çdo shkollë e arsimit parauniversitar, të hartojë Kartën e Performancës së Shkollës për vitin shkollor 2014-2015, bazuar në Udhëzuesin për Kartën e Performancës së Shkollës.

5. DAR/ZA-të të udhëzojnë institucionet arsimore për formimin e shoqatave sportive në çdo shkollë. Formimi i këtyre shoqatave të behet në mbështetje të dokumentacionit që Drejtoria e Sportit në MAS do t'u dërgojë DAR/ZA-ve dhe shkollave brenda muajit tetor 2014.

6. DAR/ZA-të, QKF-ja dhe institucionet arsimore të ndjekin me përparësi:

a) Fazat përgatitore dhe fazën finale të olimpiadave kombëtare.

b) Pjesëmarrjen në Olimpiadën Mbarëshqiptare të Matematikës me klasat 7, 8, 9, që organizohet nga Klubi i Matematikanëve dhe Infomatikanëve "Paskal" të Tetovës.

c) Pjesëmarrjen në Olimpiadës "Kangourou della matematica" që organizohet në Itali.

d) Kampionatin Kombëtar të shahut për arsimin 9-vjeçar.

e) Festivalin Kombëtar të Këngës për Fëmijë

f) Festivalin e Instrumentistëve të Vegjël Popullorë.

g) Konkursin e poezisë në trevat shqiptare.

h) Konkursin artistik "Piktori i vogël".

i) Organizimin dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit: konferenca, seminare, ekspozita, lexime publike, konkurse etj.

j) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive në kuadër të Ditës Europiane të Gjuhëve, më 26 shtator 2014.

k) Përdorimin e Portofolit Europian të Gjuhëve si një dokument i rëndësishëm për vlerësimin dhe vetëvlerësimin në përputhje me kompetencat e kërkuara nga Këshilli i Evropës sipas niveleve gjuhësore të përcaktuara nga Kuadri i Përbashkët Europian i Referencës për Gjuhët.

l) Planifikimin e veprimtarive në kuadër të përkujtimit të Holokaustit dhe krimeve kundër njerëzimit.

m) Planifikimin e veprimtarive sipas Kalendarit të Ditëve të Evropës dhe realizimin e konkurseve, në nivel DAR/ZA-je, me tematikë "Të njohim Evropën".

KREU IV

POLITIKA, STRATEGJI DHE MARRËVESHJE NDËRMINISTRORE

1. Reduktimi i braktisjes shkollore

Për reduktimin e braktisjes shkollore, DAR/ZA-të dhe shkollat e arsimit bazë:

a) Të zbatojnë me përgjegjësi Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punës (çështjeve Sociale

dhe Shanseve të Barabarta, nr. 4024 prot., datë 2.5.2013, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

b) Të koordinojnë bashkëpunimin ndërsektorial ndërmjet Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe institucioneve të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës.

c) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar, funksionimin klasave të shansit të dytë dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë.

DAR/ZA-të të raportojnë në DAPU (MAS), dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor), për punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore.

2. Programi Kombëtar COMBI

DAR/ZA-të dhe drejtoritë e institucioneve të angazhohen për vazhdimin e Programit Kombëtar COMBI. DAR/ZA-të të përgatisin raporte periodike për zbatimin e programit në kopshte dhe shkolla dhe t'i dërgojnë këto raporte në DAPU (MAS) në fund të muajve janar dhe qershor.

3. Strategji, plane kombëtare ndërministrrore dhe marrëveshje

1) Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, DAR/ZA-të, IZHA dhe ISHA, në bazë të planit të veprimit për secilën strategji kombëtare ndërministrrore, të caktojnë personat përgjegjës, të hartojnë plane pune vjetore me detyra konkrete, të monitorojnë realizimin e detyrimeve që lindin nga këto strategji dhe të kryejnë analiza për vlerësimin e përmbushjes së çdo strategjie dhe plani veprimi.

2) DAR/ZA-të, IZHA-ja dhe ISHA-ja të raportojnë në MAS, në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor, për problemet që lidhen me zbatimin e strategjive, marrëveshjeve dhe planeve kombëtare të mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom dhe Plani i Veprimit për Dekadën e përfshirjes së romëve;

b) Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar;

c) Strategjia "Për riintegrimin e emigranteve shqiptare të kthyer 2010-2015";

d) Strategjia për Luftën kundër Përdorimit të Drogës dhe Alkoolit;

e) Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore, Reduktimit të Dhunës me bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje.

f) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 2208/3, datë 20.4.2012, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për zbatimin e programit "Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme";

g) Plani i masave për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;

h) Plani i ri kombëtar për ushqimin dhe ushqyerjen;

i) Marrëveshja e Bashkëpunimit me MUBK-në nr. 4216, datë 20.3.2013, “Për realizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere në shkollat rurale për sëmundjet zootonike dhe përmirësimin e mbrojtjes kuadër sëmundjeve të mbartura nga kafshët”.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në MAS, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucione arsimore parauniversitare.

2. DAR/ZA-të të marrim masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor parauniversitar dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM
Nr. 24, datë 11.8.2014

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 33 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 517, datë 1.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014-2015”, si dhe në zbatim të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për

krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, si dhe vendimit nr. 241, datë 31.3.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen nga “Posta shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të aplikojnë direkt pranë institucioneve publike të arsimit të lartë (IAL), nga data 25 gusht deri më 10 shtator 2014 sipas kuotave të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 517, datë 1.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014-2015”, dhe sipas kuotave për programin përkatës të studimit të përcaktuara në urdhrin nr. 326, datë 8.8.2014, “Për shpërndarjen e kuotave të pranimi të studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014-2015”. Kandidatët që konkurrojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, në zbatim të udhëzimit nr. 20, datë 6.8.2014, “Për zhvillimin e konkurseve të pranimi dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014-2015”, të aplikojnë pranë IAL-ve respektive, nga data 21 gusht 2014 deri në orën 12:00 të datës 28 gusht 2014.

2. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të

legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet, të njohura në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) Dy fotografi;

d) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi.

3. IAL-të, brenda datës 11 shtator 2014, të përcjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) listën e kandidatëve të cilët përmbushin kriteret e pranimit, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në gerrat “a”, “b” dhe “d” të pikës 2 të këtij udhëzimi, si dhe një shkresë shoqëruese ku deklarohen kriteret e pranimit të aplikuar, si dhe aktin e miratimit të tyre (rregullore, statut). Në rastet kur numri i kandidatëve për një program të caktuar studimi është më i vogël ose i barabartë me numrin e kuotave të miratuara për këtë program studimi IAL përcjell për miratim në MAS listën e kandidatëve.

4. Në rastet kur numri i kandidatëve për një program të caktuar studimi është më i lartë se numri i kuotave të miratuara për këtë program studimi, përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Komisioni, në përzgjedhjen e kandidatëve, bazohet në notën mesatare të shkollës së mesme dhe notat e lëndëve për të cilat IAL-të publike kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik, për programin përkatës të studimit. Nëse, edhe duke u bazuar në këto kriteret, do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, ata do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS-i.

5. Brenda datës 25 shtator 2014, MAS-i përcjell në IAL-të respektive listën e kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme, si dhe listën, e miratuar nga MAS-i, të kandidatëve të përcjellë nga IAL-të, në zbatim të pikës 3 të këtij udhëzimi, për të vijuar me regjistrimin e kandidatëve në programet përkatëse të studimit. MAS-i publikon në faqen web listën e kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

6. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në periudhën 29 shtator deri më 8 tetor 2014 dhe i dorëzojnë mandat arketimin e tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë, paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së publike përkatëse. IAL-të, brenda datës 10 tetor 2014, përcjellin listat emërore të kandidatëve të regjistruar, në MAS dhe AKP (për gjenerimin e numrit të matrikullimit), në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të dërguar nga AKP-ja, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3

të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit”, i ndryshuar.

7. Në përfundim të procedurave të seleksionimit, MAS-i vlerëson mundësinë e rishpërndarjes së kuotave të mbetura bosh. Mund të përfitojnë nga kuotat e rishpërndara kandidatët, të cilët kanë aplikuar pranë IAL-ve brenda datës 10 shtator 2014 dhe nuk kanë rezultuar fitues në raundin e parë të shpërndarjes së kuotave.

8. MAS-i procedon me përcaktimin e emrave të kandidatëve në programet ku janë rishpërndarë kuotat dhe brenda datës 3 tetor 2014 i përcjell IAL-ve respektive listat e kandidatëve fitues. MAS-i publikon në faqen web listën e kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

9. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në periudhën nga data 6 tetor 2014 deri më 13 tetor 2014, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, të cilat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të noterizuara në Republikën e Shqipërisë. IAL-të, brenda datës 16 tetor 2014, përcjellin listat emërore të kandidatëve të regjistruar, në MAS dhe AKP, për gjenerimin e numrit të matrikullimit, në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të dërguar në AKP, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit”, i ndryshuar.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike përkatëse të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

Tiranë, më ____/____/2014

AUTORIZIM

Unë i nënshkruari _____ autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të pranimit në programin e studimit të ciklit të parë/ të integruar të ciklit të dytë _____ ofruar nga institucioni i arsimit të lartë i sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Emër Atësi Mbiemër

Firma

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (TABELA NR. 2)
PIKËT MAKSIMALE DHE MINIMALE SIPAS PROGRAMEVE NË KONKURSET E PRANIMIT

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Pikët maksimale	Pikët minimale
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	130	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	167	Edukim Fizik dhe Sporte	70	0
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	241	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	242	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	100	40
Universiteti i Arteve, Tiranë	243	Regji Filmi dhe Televizioni	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	244	Aktrim	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	245	Regji	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	246	Skenografi - Kostumografi	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	247	Koreografi	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	248	Pikturë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	249	Skulpturë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	250	Muzikologji	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	251	Kompozim	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	252	Dirizhim	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	253	Piano	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	254	Violinë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	255	Violonçel	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	256	Violë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	257	Kitarë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	258	Kontrabas	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	259	Flaut	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	260	Oboe	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	261	Klarinetë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	262	Fagot	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	263	Korno	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	264	Trombë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	265	Trombonë	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Bastub	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	267	Kanto	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	268	Pedagogji Muzikore	240	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	269	Fizarmonikë Klasike	240	60
Universiteti i Sporteve të Tiranës	270	Shkencat e Lëvizjes	70	0
Universiteti i Sporteve të Tiranës	271	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	70	0

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT (TABELA NR. 1)
PËRQINDJA QË ZË MATURA SHETËRORE NË PIKËT FINALE TË MERITË - PREFERENCËS

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT	% e Maturës Shtetërore	% e Konkursit të Pranimit
Universiteti "Aleksandër Xhuvani"-Elbasan	130	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	167	Edukim Fizik dhe Sporte	50	50
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	241	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	242	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	40	60
Universiteti i Arteve, Tiranë	243	Regji Film dhe Televizioni	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	244	Aktrim	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	245	Regji	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	246	Skenografi - Kostumografi	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	247	Koreografi	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	248	Pikturë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	249	Skulpturë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	250	Muzikologji	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	251	Kompozim	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	252	Dirizhim	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	253	Piano	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	254	Violinë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	255	Violonçel	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	256	Violë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	257	Kitarë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	258	Kontrabas	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	259	Flaut	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	260	Oboe	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	261	Klarinetë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	262	Fagot	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	263	Korno	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	264	Trombë	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	265	Trombone	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Bastub	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	267	Kanto	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	268	Pedagogji Muzikore	30	70
Universiteti i Arteve, Tiranë	269	Fizarmonikë Klasike	30	70
Universiteti i Sporteve të Tiranës	270	Shkencat e Lëvizjes	50	50
Universiteti i Sporteve të Tiranës	271	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	50	50

TABELA NR. 1									
KUOTAT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË ÇIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË ÇIKUT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015									
EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Kuotat për kandidatët nga Kosova	Kuotat për kandidatët shqiptarë nga Mali i Zi	Kuotat për kandidatët shqiptarë nga Maqedonia	Kuotat për kandidatët shqiptarë nga Presheva	Kuotat për kandidatët shqiptarë nga Bujanovci	Kuotat për kandidatët shqiptarë nga Medvegja	TOTALI I KUOTAVE TË TROJEVE
Universiteti i Tiranës	001	Histori	-	2	5	-	1	-	8
Universiteti i Tiranës	002	Gjeografi	-	2	5	-	-	-	7
Universiteti i Tiranës	003	Gjuhë - Letërsi	-	3	5	1	1	-	10
Universiteti i Tiranës	004	Gazetari	5	2	-	-	1	-	8
Universiteti i Tiranës	005	Arkeologji	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Tiranës	006	Biologji	-	1	5	-	-	-	6
Universiteti i Tiranës	007	Bioteknologji	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	008	Matematike	4	2	-	2	1	1	10
Universiteti i Tiranës	009	Fizike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	010	Informatike	-	3	-	1	1	1	6
Universiteti i Tiranës	011	Kimi	-	2	-	-	1	-	3
Universiteti i Tiranës	012	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	013	Kimi Industriale dhe Mjedisore	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	014	Inzhinieri Matematike dhe Informatike	-	4	-	2	1	-	7
Universiteti i Tiranës	015	Teknologji Informatike dhe Komunikimi	-	-	-	2	1	-	3
Universiteti i Tiranës	016	Gjuhë Angleze	7	-	1	1	1	-	10
Universiteti i Tiranës	017	Gjuhë Frenge	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	018	Gjuhë Gjermane	-	2	1	1	1	-	5
Universiteti i Tiranës	019	Gjuhë Italiane	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	020	Gjuhë Greke	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	021	Gjuhë Turke	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	022	Gjuhë Ruse	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	023	Gjuhë Spanjolle me profil Gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	024	Psikologji	3	-	4	1	1	-	9
Universiteti i Tiranës	025	Punë Sociale	-	-	4	-	-	-	4
Universiteti i Tiranës	026	Filozofi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	027	Sociologji	-	2	4	-	-	-	6
Universiteti i Tiranës	028	Shkenca Politike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	029	Administrim dhe Politika Sociale	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës	030	Administrim - Biznes	-	3	4	1	2	1	11
Universiteti i Tiranës	031	Ekonomiks	-	3	-	2	2	1	8
Universiteti i Tiranës	032	Finance	-	4	3	1	2	1	11
Universiteti i Tiranës	033	Informatike Ekonomike	-	2	-	2	2	1	7
Universiteti i Tiranës	034	Drejtësi	3	3	4	1	1	-	12
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	035	Mjekësi e Përgjithshme	-	2	4	4	4	1	15
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	036	Farmacitë	-	1	-	4	4	-	9
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	037	Stomatologji	-	1	-	2	2	-	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	038	Shëndet Publik	2	1	-	1	1	-	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	039	Infermieri e Përgjithshme	-	3	3	1	1	-	8
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	040	Mami	-	1	1	2	1	-	5
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	041	Teknik i Lartë Laboratori	-	-	4	2	1	-	7
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	042	Fizioterapi	-	-	4	3	2	-	9

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	043	Logopedi	-	1		1	1	-	3
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	044	Imazheri	-	-	1	1	1	-	3
Universiteti Bujqësor i Tiranës	045	Menaxhim Agrobiznesi	-	-	2	1	1	-	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	046	Ekonomi dhe Politikë Agrare	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	047	Financë – Kontabilitet	-	-	1	1	1	1	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	048	Menaxhim i Turizmit Rural	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	049	Informatikë Biznesi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	050	Ekonomiks i Aplikuar	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	051	Mbrojtje Bimësh	2	-	2	-	-	-	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	052	Hortikulturë	1	-	2	-	-	-	3
Universiteti Bujqësor i Tiranës	053	Prodhim Bimor	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	054	Zooteknë dhe Biznes Blegtoral	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	055	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	056	Agromjedis dhe Ekologji	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti Bujqësor i Tiranës	057	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	2	-	2	-	-	-	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	058	Teknologji Agroushqimore	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	059	Vreshtari - Enologji	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Bujqësor i Tiranës	060	Mbarështim Pyjesh	2	-	2	-	-	-	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	061	Perpunim Druri	2	-	2	-	-	-	4
Universiteti Bujqësor i Tiranës	062	Mjekësi Veterinare	-	-	-	1	1	-	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	063	Inxhinieri Ndërtimi	2	-	-	2	1	-	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	064	Inxhinieri Hidroteknike	2	2	-	-	-	-	4
Universiteti Politeknik i Tiranës	065	Inxhinieri Mjedis	2	1	-	-	-	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	066	Arkitekturë (Arkitekt)	2	2	-	1	1	-	6
Universiteti Politeknik i Tiranës	067	Arkitekturë (Urbanist)	2	3	-	-	-	-	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	068	Inxhinieri Gjeodet	2	1	-	1	1	-	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	069	Inxhinieri Elektrike (Automatizim i Industrisë)	-	-	-	2	1	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	070	Inxhinieri Elektrike (Energjitike)	-	-	-	2	1	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	071	Inxhinieri Mekatronike	1	1	-	-	-	-	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	072	Inxhinieri Fizike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Politeknik i Tiranës	073	Inxhinieri Matematike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Politeknik i Tiranës	074	Inxhinieri Mekanike	2	3	-	-	-	-	5
Universiteti Politeknik i Tiranës	075	Inxhinieri Tekstile dhe Modë	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	076	Inxhinieri Materiale	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Politeknik i Tiranës	077	Inxhinieri Ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Politeknik i Tiranës	078	Inxhinieri Gjeologjike	2	1	-	-	-	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	079	Inxhinieri Gjeoburimesh	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	080	Inxhinieri Gjeoinformatike	2	1	-	-	-	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	081	Inxhinieri Gjeomjedis	2	1	-	-	-	-	3

Universiteti Politeknik i Tiranës	082	Inxhinieri Elektronike	-	-	-	1	1	-	2
Universiteti Politeknik i Tiranës	083	Inxhinieri Informatike	-	-	-	2	1	-	3
Universiteti Politeknik i Tiranës	084	Inxhinieri Telekomunikacioni	-	-	-	1	1	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	085	Gjuhë - Letërsi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	086	Gjuhë Angleze	1	-	4	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	087	Mësuesi për Arsimin Fillor	2	-	3	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	088	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	2	-	2	1	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	089	Histori - Gjeografi	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	090	Filozofi - Sociologji	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	091	Matematike - Fizike	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	092	Matematike - Informatikë	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	093	Biologji - Kimi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	094	Teknologji Informacioni	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	095	Infermieri e Përgjithshme	4	-	3	-	-	-	7
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	096	Mami (Infermier)	-	-	5	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	097	Administrim dhe Politika Sociale	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	098	Financë - Kontabilitet	-	-	5	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	099	Menaxhim	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	100	Administrim Biznesi në Marketing	-	-	5	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	101	Administrim Biznesi në Turizëm	-	-	5	-	-	-	5
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	102	Agroushqim	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	103	Agrobiznes	-	-	2	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	104	Gjuhë - Letërsi	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	105	Histori - Gjeografi	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	106	Gjeografi dhe Gjuhë Italiane	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	107	Gjuhë Angleze	1	-	1	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	108	Gjuhë Frënge	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	109	Gjuhë Italiane	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	110	Gazetari	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	111	Gazetari - Anglisht	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	112	Biologji - Kimi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	113	Matematike - Fizike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	114	Teknologji e Informacionit	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	115	Teknologji Laboratori (2 vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	116	Fizikë Kompiuterike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	117	Matematikë Informatike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	118	Infermieri e Përgjithshme	-	2	1	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	119	Infermieri - Mami	1	2	-	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	120	Fizioterapi	-	2	-	-	-	-	2

Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	121	Logopedi	-	3	-	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	122	Imazheri	-	2	1	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	123	Teknologji Laboratori	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	124	Mësuesi për Arsimin Fillor	2	2	-	2	2	1	9
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	125	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	-	2	-	-	1	-	3
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	126	Edukim Qytetar	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	127	Punonjës Social	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	128	Filozofi - Sociologji	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	129	Psikologji	3	2	-	-	-	-	5
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	130	Edukim Fizik dhe Sporte	2	2	2	2	2	-	10
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	131	Administrim - Biznes	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	132	Financë - Kontabilitet	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	133	Ekonomia dhe e Drejta	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	134	Informatike Ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	135	Ekonomi Turizmi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	136	Administrim Biznesi dhe Inzhinieri	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	137	Shkenca Juridike në Biznes	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Xhuvani" Elbasan	138	Shkenca Juridike në Sektorin Publik	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	139	Biologji - Kimi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	140	Matematike-Informatike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	141	Teknologji Informacioni	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	142	Infermieri e përgjithshme	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	143	Infermieri Mani	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	144	Histori - Gjeografi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	145	Gjuhë - Letërsi Shqipe	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	146	Gjuhë Letërsi Angleze	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	147	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	148	Mësuesi për Arsimin Fillor	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	149	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	150	Kontabilitet - Financë	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	151	Administrim - Publik	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	152	Gjuhë - Letërsi	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	153	Gazetari dhe Komunikim	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	154	Histori	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	155	Gjeografi	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	156	Matematike	2	3	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	157	Fizikë	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	158	Informatike	-	3	-	-	-	-	3
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	159	Biologji - Kimi	-	4	-	-	-	-	4

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	160	Infermieri e Përgjithshme	2	3	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	161	Infermieri (Mami)	1	4	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	162	Infermieri (Fizioterapi)		3	-	-	-	-	3
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	163	Mësuesi për Arsimin Fillor		4	-	-	-	-	4
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	164	Mësuesi për Arsimin Parashkollor		7	-	-	-	-	7
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	165	Psikologji	1	4	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	166	Punë Sociale	-	4	-	-	-	-	4
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	167	Edukim Fizik dhe Sporte	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	168	Financë - Kontabilitet	-	5	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	169	Administrim - Biznes	-	5	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	170	Turizëm	-	5	-	-	-	-	5
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	171	Gjuhë Angleze	-	8	-	-	-	-	8
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	172	Gjuhë Italiane	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	173	Gjuhë Gjermane	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	174	Gjuhë Frengje	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	175	Drejtësi	-	5	-	-	-	-	5
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	176	Matematike	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	177	Shkenca Kompjuterike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	178	Teknologji Informacioni	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	179	Informatike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	180	Inzhinieri Navale	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	181	Inzhinieri Mekanike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	182	Navigacion dhe Peshkim Detar	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	183	Biologji	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	184	Inzhinieri Elektrike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	185	Administrim Biznesi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	186	Menaxhim Turizmi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	187	Ekonomiks	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	188	Financë	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	189	Kontabilitet	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	190	Marketing	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	191	Mësuesi për Arsimin Fillor	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	192	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	193	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	194	Gjuhë Angleze	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	195	Gjuhë Italiane	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	196	Histori - Gjeografi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	197	Drejtësi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	198	Infermieri e Përgjithshme	-	-	-	-	-	-	-

Universiteti "Ismail Qemali"	199	Infermier Mami	1	-	-	-	-	-	1
Vlorë									
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	200	Administrim Biznesi	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	201	Menaxhim - Marketing	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	202	Shkenca Ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	203	Finance -Kontabilitet	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	204	Bankë Financë	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	205	Menaxhim Hotel Restorant	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	206	Menaxhim Turizëm Kulturor	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	207	Menaxhim Turizëm Arkeologjik	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	208	Drejtësi	-	2	2	-	-	-	4
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	209	Shkenca Politike	-	3	-	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	210	Administrim Publik	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	211	Politike Ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	212	Marrëdhënie me Publikun	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	213	Histori	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	214	Infermieri e Përgjithshme	1	-	2	1	1	-	5
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	215	Mami	-	-	-	1	1	-	2
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	216	Fizioterapi	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	217	Navigacion dhe Peshkim Detar	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	218	Teknike Elektrike (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	219	Hidroteknike Ujesjelles Kanalizime (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	220	Asistencë Stomatologji (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	221	Menaxhim Ndërtimi (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	222	Menaxhim Transporti (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	223	Asistencë Ligjore (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	224	Asistencë Administrative (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	225	Teknologji Automobilash (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	226	Teknike e Rrjetëve Kompjuterike (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	227	Informatikë Praktike (2- vjeçar)	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	228	Gjuhë Angleze	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	229	Mësuesi për Arsimin Fillor	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	230	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	231	Ekspert Procesi Formimi	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	232	Psikologji-Sociologji	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	233	Gjuhë Letërsi - Anglisht	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	234	Gjermanisht-Anglisht	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	235	Shkenca Kompjuterike	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	236	Sistemet e Informacionit	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	237	Teknologji Informacioni	-	-	-	-	-	-	-

Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	238	Matematike - Informatikë	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	239	Informatike - Anglisht	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	240	Multimedia dhe Televizioni Dixhital	2	1	-	-	-	-	3
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	241	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	5	2	-	-	-	-	7
Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës	242	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	243	Regji Filmi dhe Televizioni	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	244	Aktrim	-	2	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	245	Regji	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	246	Skenografi - Kostumografi	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	247	Koreografi	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	248	Pikturë	1	2	-	-	-	-	3
Universiteti i Arteve, Tiranë	249	Skulpturë	2	-	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	250	Muzikologji	-	-	1	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	251	Kompozim	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	252	Dirizhim	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	253	Piano	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	254	Violinë	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	255	Violonçel	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	256	Violë	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	257	Kitarë	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	258	Kontrabas	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	259	Flaut	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	260	Oboe	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	261	Klarinetë	1	-	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	262	Fagot	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	263	Korno	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	264	Trombë	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	265	Trombonë	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Bastub	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Arteve, Tiranë	267	Kanto	1	1	-	-	-	-	2
Universiteti i Arteve, Tiranë	268	Pedagogji Muzikore	-	1	-	-	-	-	1
Universiteti i Arteve, Tiranë	269	Fizarmonike Klasike	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Sporteve të Tiranës	270	Shkencat e Lëvizjes	-	2	1	-	-	-	3
Universiteti i Sporteve të Tiranës	271	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	-	1	1	-	-	-	2
Totali			119	208	147	61	56	9	600

UDHËZIM
Nr. 25, datë 11.8.2014

**PËR PROCEDURAT QË DO TË NDIQEN PËR
ORGANIZIMIN E PROCESIT TË TRANSFERIMIT
TË STUDENTËVE NGA INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË TË CILËVE IU ËSHTË
HEQUR LICENCA**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 539, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë",

UDHËZOJ:

1. Studentët që në vitin 2013-2014 kanë ndjekur studimet në një nga institucionet e arsimit të lartë, të cilëve u është hequr licenca me vendimin nr. 539, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë", mund të transferojnë studimet e tyre në programe studimi të njëjta apo të ngjashme të të njëjtit cikël studimi në një universitet publik ose privat të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit.

2. IAL-të, të cilave u është hequr licenca, të mbyllin të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore-shkencore për vitin akademik 2013-2014, në të gjitha ciklet e studimit ku ata ushtrojnë veprimtarinë dhe për të gjitha programet e studimit të ofruara dhe brezat e studenteve që kanë filluar studimet pas miratimit të aktit të hapjes së programit të studimit. IAL-të të organizojnë sesione të jashtëzakonshme provimesh dhe mbrojtje të temave të diplomës, për studentë të cilët nuk kanë arritur të shlyejnë detyrimet e vitit akademik 2013-2014. IAL-ja përcakton një plan të qartë me data dhe objektiva konkretë, të cilin ia vë në dispozicion Ministrisë së Arsimit dhe Sportit brenda datës 13 gusht 2014 në formë shkresore, si dhe elektronike në adresën vgl@arsimi.gov.al.

3. Për të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet dhe mbrojtjen e temës së diplomës, të cilët rezultojnë të regjistruar në një program studimi pas datës së miratimit të hapjes së tij nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dhe kur programi i studimit që kanë ndjekur është akredituar në Republikën e Shqipërisë, institucioni i arsimit të lartë, të cilit i është hequr licenca, të marrë të gjitha masat për të lëshuar diplomën dhe suplementin përkatës, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, brenda datës 1 shtator 2014.

4. Institucionet e arsimit të lartë, të cilave iu është hequr licenca, kanë detyrimin të përgatisin dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për çdo student, brenda datës 1 shtator 2014, dhe t'ia vënë atë në dispozicion çdo studenti pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e studentit.

5. Dosja e studentit të përmbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mundësuar çregjistrimin nga kjo IAL dhe regjistrimin në një IAL tjetër, si më poshtë:

a) Dokumenti i çregjistrimit;
b) Plani i plotë i programit të studimit;
c) Lista e lëndëve të shlyera me notat dhe kreditet përkatëse;

d) Lista e notave dhe kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, e cila do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

e) Kopje e kontratës së lidhur në kohën e regjistrimit të studentit në IAL përkatëse dhe kopje e dokumentit që dëshmon zgjidhjen e kontratës;

f) Diplomë e cikleve të mëparshme të studimit dhe/ose të shkollës së mesme të kryer nga studenti (institucioni mban një fotokopje të vulosur nga vetë institucioni), si dhe kopje të dosjes së regjistrimit fillestar të studentit në këtë IAL.

6. Dokumenti i çregjistrimit të jetë origjinal dhe individual, dhe të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) Emri, atësia, mbiemri;
b) Datëlindja;
c) Vendlindja;
ç) Shtetësia;
d) Numri i matrikullimit;
dh) Emri i shkollës së mesme/IAL-së së kryer përpara ndjekjes së këtij programi studimi;
e) ID e Maturës Shtetërore/nr. regj. të veçantë;
ë) Numri personal i identitetit;
f) Data e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;
g) Emërtimi i programit të studimit dhe fakultetit përkatës;
gj) Cikli dhe forma e studimit;
h) Data e ndërprerjes së studimeve.

7. Plani i plotë i programit të studimit, pjesë e dosjes së studentit, është plani i dorëzuar nga IAL-ja në kërkesën për licencimin/hapjen e programit të studimit ose ai i ndryshuar dhe miratuar më pas sipas procedurave të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë dokument të shënohen kreditet (ECTS) për çdo lëndë/syllabus.

8. Studentët, brenda datës 20 shtator 2014, kanë të drejtë të aplikojnë për transferimin e studimeve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Për të aplikuar, studentët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dosjen e studentit, që përmban sa parashikohet në pikën 5 të këtij udhëzimi;

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të

vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme, së bashku me vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Provimeve për shlyerjen eventuale të provimeve me zgjedhje. Në rastet kur dokumenti është lëshuar nga një institucion i huaj ai duhet legalizuar në vendin ku ndodhet institucioni që e ka lëshuar dhe duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe;

c) Për studentët që aplikojnë për transferim të studimeve në programe studimi të ciklit të dytë, fotokopje të noterizuar e diplomës/diplomave të ciklit/cikleve të mëparshme të studimit të arsimit të lartë së bashku me certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës/diplomave përkatëse. Në rastet kur dokumenti është lëshuar nga një institucion i huaj ai duhet legalizuar në vendin ku ndodhet institucioni që e ka lëshuar dhe duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe i njohur në Republikën e Shqipërisë nga Komisioni i Njohjes së diplomave të arsimit të lartë në MAS. Në qoftë se kandidati nuk ka diplome të Maturës Shtetërore apo dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të saj, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/zyra arsimore përkatëse ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

d) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

e) Dy fotografi;

f) Deklaratë e kandidatit që ai nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe që nuk do të ndjekë njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku ai po aplikon;

g) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi.

Institucionet pritëse ngrenë në nivel njësie kryesore komisionin e vlerësimit, njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve të grumbulluara nga studenti, si dhe të periudhave të studimit. Ky komision ngrihet me vendim senati akademik mbi bazën e propozimeve të ardhura nga njësitë kryesore përkatëse. Në rastin e institucioneve private të arsimit të lartë, senati përcakton dhe numrin maksimal të studentëve që do të pranohen në zbatim të këtij vendimi në çdo program studimi, në mënyrë që të respektohen standardet e cilësisë të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

9. Komisioni i vlerësimit, njohjes dhe ekuivalentimit, i ngritur në IAL-të pritëse, mbledhet brenda datës 25 shtator 2014. Ai kryen renditjen e studentëve aplikantë

mbi bazën e një sistemi pikëzimi të vendosur me vendim të senatit akademik. Sistemi i pikëzimit konsiston të paktën në notën mesatare të studimeve të shkollës së mesme, studimeve universitare pararendëse dhe performancës (ritmit) së shlyerjeve të detyrimeve akademike në IAL-të paraardhëse. Në përfundim të vlerësimit dhe renditjes së aplikantëve, Komisioni përcakton listën e kandidatëve që do të pranohen, në rastin e IAL-ve publike, duke u bazuar në numrin e kuotave të parashikuara për transferimet, ndërsa në rastin e IAL-ve private, duke u bazuar në numrin maksimal të studentëve për program studimi të përcaktuar me vendim të senatit akademik.

10. Lista e kandidatëve, e përcaktuar sipas parashikimeve në pikën 9 të këtij udhëzimi, i përcillet dekanatit përkatës brenda datës 6 tetor 2014. Institucioni hap procedurat për regjistrimet e kandidatëve nga data 7 tetor 2014 deri në orën 12:00 të datës 10 tetor 2014. IAL-ja shpall listat e kandidatëve të regjistruar për program studimi brenda orës 16:00 të datës 10 tetor 2014 në vende të dukshme, si dhe ia përcjell atë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në formë elektronike në adresën vgl@arsimi.gov.al brenda po së njëjtës datë. Në rast të mos plotësimit të kuotave të miratuara, IAL-ja hap fazën e dytë të regjistrimeve, nga data 13 tetor 2014 deri në orën 12:00 të datës 16 tetor 2014, për kandidatët sipas renditjes zbritëse në listën e përcaktuar nga Komisioni i vlerësimit. IAL-ja shpall listat përfundimtare të kandidatëve të regjistruar për program studimi brenda orës 16:00 të datës 16 tetor 2014 në vende të dukshme.

11. Lista përfundimtare e kandidatëve të regjistruar i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, e shoqëruar me argumentimin mbi mënyrën e përzjedhjes së kandidateve, brenda datës 16 tetor 2014, në formë shkresore dhe elektronike në adresën vgl@arsimi.gov.al. Një kopje e listës i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Provimeve për gjenerimin e numrave të matrikullimit.

12. Listat e kandidatëve që i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në zbatim të pikës 10 dhe 11 të këtij udhëzimi të përmbajnë të dhënat sipas shtojcës 2 bashkëlidhur dhe të përcillet sipas specifikimeve me sipër në formë shkresore dhe /ose elektronike sipas rastit. Përcjellja në formë elektronike duhet të bëhet në format Excel.

13. Për verifikimin e procedurave të mësipërme, si dhe menaxhimin e të gjithë procesit në vijim të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 539, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë", pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit, ngrihet një Komision i Posaçëm me këto kompetenca:

a) Të kërkojë informacion dhe të verifikojë procedurat e ndjekura për transferimin e studimeve nga institucionet e arsimit të lartë të cilave iu është hequr licenca, si dhe institucionet pritëse;

b) Të mbikëqyrë procedurat e ndjekura nga komisionet e vlerësimit, njohjes dhe ekuivalentimit të ngritura pranë IAL-ve pritëse;

c) Të monitorojë zbatimin e sa parashikohet në vendimin nr. 539, datë 6.8.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë";

d) Të informojë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit brenda ditës për shkeljet, parregullsitë dhe abuzimet e konstatuara;

e) Të organizojë veprimtari informuese, në bashkëpunim me zyrën e marrëdhënieve me publikun në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për kuadrin ligjor dhe procedurat që duhen ndjekur nga studentët që do të transferojnë studimet.

14. Komisioni i Posaçëm brenda datës 20 tetor 2014 harton raportin përfundimtar mbi ecurinë e procedurave të transferimit të studenteve.

15. Institucionet e arsimit të lartë, të cilave u hiqet licenca, nuk kanë të drejtë të kryejnë asnjë veprim financiar apo lëvizje në llogaritë bankare të institucionit, përveç atyre që kanë lidhje me kthimin e pagesave të kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të kenë ndaj studentit.

16. IAL-të që u është hequr licenca të kryejnë likuidimin e studentëve sipas parashikimeve të vendimit nr. 539, të Këshillit të Ministrave, "Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë" dhe këtij udhëzimi.

17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri për Arsimin e Lartë, Sekretari Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

Tiranë, më ____/____/2014

AUTORIZIM

Unë nënshkruari _____ autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të transferimit të studimeve në programin e studimit _____ të ofruar nga institucioni i arsimit të lartë i sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Autorizoj, gjithashtu, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me procesin e transferimit, me periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

Emër Atësi Mbiemër

Firma

Shtojca 2

nr	Emri	Mbiemri	Atësia	Datëlindja	Vendlindja	Shtetësia	Numri personal i identitetit	Numri i matricullimit të programit të studimit nga ku transferohet	Data e regjistrimit në programin e studimit nga ku po transferohet	Data e ndërprerjes së studimeve në institucionin privat të cilit i është hequr licenca	Institucioni nga ku po transferohet	Emërtimi i programit të studimit nga ku po transferohet	Cikli i programit të studimit nga ku po transferohet (Bachelor, MSc, MP, etj)	Viti i studimit që ka ndjekur në vitin akademik 2013-2014	Institucioni pritës	Emërtimi i programit të studimit ku po transferohet	Cikli i programit të studimit ku po transferohet (Bachelor, MSc, MP, etj)	Data e regjistrimit në IAL-në pritëse	Numri i krediteve të njohura nga IAL pritëse
1																			
2																			
3																			
4																			
...																			

nr										
1		Numri i lëndëve të njohura nga IAL pritëse								
2		Viti i studimit në të cilin transferohet në vitin akademik 2014-2015								
3		Shkolla e mesme ku ka kryer studimet përpara ndjekjes së programit të studimit nga ku po transferohet								
4		IAL ku ka kryer studimet e ciklit të parë (për studentët që po ndiqnin një program të ciklit të dytë)								
...		Emërtimi i programit të studimit të ciklit të parë (për studentët që po ndiqnin një program të ciklit të dytë)								
		Numri i matricullimit të programit të studimit të ciklit të parë (për studentët që po ndiqnin një program të ciklit të dytë)								
		ID e Maturës Shtetërore/nr. Regj. të veçantë								
		Emri i shkollës ku ka kryer arsimin e mesëm								
		Numri i krediteve të njohura nga IAL pritëse								
		Numri i lëndëve të njohura nga IAL pritëse								

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006